



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL
Tiranë, më 11.12.2019, ora 10:00
Drejton mbledhjen:
Arben Ahmetaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet qeverisë së republikës së shqipërisë dhe qeverisë së shteteve të bashkuara të ameriksë, për programin e shkëmbimit akademik “fulbright””
2. Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet këshillit të ministrave të republikës së shqipërisë dhe qeverisë së republikës federale të gjermanisë, për bashkëpunim teknik 2018, për projektin “menaxhimi i modernizuar i mbetjeve dhe ekonomia ricikluese në respekt të mjedisit (dkti)””
3. Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet këshillit të ministrave të republikës së shqipërisë dhe qeverisë së republikës federale të gjermanisë, për bashkëpunim financiar 2018, për projektin “programi për infrastrukturën komunale v”
4. Shqyrtimi i projektligjit “Për një ndryshim në ligjin nr. 55/2015 "për investimet strategjike në republikën e shqipërisë, të ndryshuar" ne republikën e shqipërisë, të ndryshuar" – *Nismë e deputetit, Ilir Beqja*
5. Shqyrtimi i projektligjit “Për rivlerësimin e pasurisë së paluajtshme” – *Nismë e deputetit Arben Ahmetaj*

Marrin pjesë:

Arben Ahmetaj, Arben Elezi, Anastas Angjeli, Ervin Bushati, Blerina Gjylameti, Evis Kushi, Xhavit Bushaj, Roland Xhelilaj, Senida Mesi, Vullnet Sinaj, Eljo Hysko, Edlira Hyseni, Suzana Topi, Artur Roshi, Krenar Ryci, Korab Lita dhe Ylli Shehu, Reme Lala

Mungojnë:

Antoneta Dhima,

Të ftuar:

Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinise

1. Z. Kostandin Shkurti, Zëvendësministër;
2. Z. Erzen Tola, Drejtor i Përgjithshëm Rregullator dhe i Përputhshmërisë për Arsimin, Sportin dhe Rininë.

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit

1. Z. Blendi Klosi, Minister
2. Z. Adrian Kamenica, Sekretari I Përgjithshëm
3. Z. Zamir Dedej, Drejtor i Agjensisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura

Ministria e Financave dhe Ekonomisë

1. Znj. Belinda Ikonimi, Zëvendësministër
2. Z. Nikolla Lera, Drejtor I Përgjithshëm
3. Z. Saimir Mucmataj, Drejtor

HAPET MBLEDHJA

Arben Ahmetaj – Kemi axhendë të ngjeshur, kështu që komisioni do të duhet të punojë edhe paradite, edhe pasdite, sepse edhe paketa, edhe buxheti i vitit 2020, më datë 18 do të kalojë nën për nën e në tërësi në parlament. Kjo do të thotë se të gjitha nismat që kemi ndërmarrë edhe ne si komision, do të duhet të formatohen. Zyrtarisht, dua të ndaj me komisionin faktin se, i rakorduar edhe me qeverinë, unë do të fus edhe disa ndryshime dhe një nismë, e cila ka të bëjë me TVSH-në, të rakorduar me Ministrinë e Financave: për heqjen e TVSH-së në importin e gjithë lëndës së parë për ndërtim, brenda programit të rindërtimit, që do të kalojë me buxhetin.

Gjithashtu, zoti Lera, të kihet parasysh edhe procesi i ndërtimit të banesave vetëm brenda programit të rindërtimit, si dhe heqja e taksës së infrastrukturës për ndërtimet që bëhen brenda programit të rindërtimit.

Këto janë iniciativa të Kryeministrit, menjëherë pas datës 26 nëntor. Nuk janë në paketë, sepse paketa ka ardhur përpara datës 26, kështu që, si iniciativa, do të rakordohen me komisionin, do të formatohen dhe do të bëhen si nisma e amendamente të miat, në emër të qeverisë. Dakord? Meqenëse proceduralisht, qeveria nuk mund të sjellë nismë, pa e kaluar në qeveri.

Atëherë, vazhdojmë! Do t'ju lutesha që, meqë kemi shumë punë, të jemi racionalë. Gjithashtu, do t'ju lutesha t'i lëmë debatet e kota politike dhe të fokusohemi tek lënda.

Faleminderit!

Fillojmë me shqyrtimin e projektligjit “Për ratifikimin e memorandumit të mirëkuptimit midis Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për programin e shkëmbimit akademik Fulbright”.

Më pas kemi shqyrtimin e projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin teknik 2018, për projektin “Menaxhimi i modernizuar i mbetjeve dhe ekonomia ricikluese në respekt të mjedisit”.”

Këtë e kemi për dhënie mendimi.

Më thonë se ka edhe një marrëveshje financiare. Është kështu, Alma? Ka edhe një marrëveshje financiare. Dua të sillët edhe marrëveshja financiare, që ta kalojmë po sot në komision.

Kemi shqyrtimin e projektligjit “Për një ndryshim në ligjin 55/2015 “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar”.”

Nisma është e deputetit Ilir Beqaj. Do ta prezantoj vetë, meqë zoti Beqaj nuk është i pranishëm.

Nisma ime, e rakorduar me qeverinë, për shqyrtimin e projektligjit “Për rivlerësimin e pasurive të paluajtshme”, nismë e deputetit Arben Ahmetaj.

Para se të fillojmë po sot fiskalizimin, do të bëjmë një diskutim me komisionin dhe me ministrin e Financave, jashtë procedure, për të parë ato ndryshime. Pastaj do të ftojme edhe kamerat, që të na dëgjojnë e të na ndjekin.

Faleminderit!

Kemi të ftuar:

Zëvendësministrin e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, zotin Kostandin Shkurti,

Zotin Erzen Tola, Drejtor i Përgjithshëm Rregullator dhe i Përputhshmërisë i Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Ju lutem, fjala për ju!

Ju lutem, zoti zëvendësministër, sa më shpejt. Do t’ju lutesha të mos na lexonit relacionin.

Kostandin Shkurti – I nderuar zoti kryetar,

Të nderuar deputetë, anëtarë të Komisionit të Ekonomisë dhe Financave,

Jemi këtu, përpara jush, për të shqyrtuar projektligjin “Për ratifikimin e memorandumit të mirëkuptimit midis Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për programin e shkëmbimit akademik Fulbright”.

Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, sipas iniciativës së ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Tiranë, pas disa diskutimeve, ka sjellë para jush hartimin e projektvendimit, i cili ka kaluar me vendim qeverie nr. 627, datë 23 shtator 2019.

Në vijim, duke qenë se miratimi i këtij memorandumi ka sjellë si pasojë marrjen përsipër të detyrimeve financiare, ky memorandum duhet të ratifikohet sipas neneve nr. 121, 78, 83, pika 1 të Kushtetutës.

Projektligji ka dy nene: ratifikimin e tij para parlamentit, e njëkohësisht hyrjen e tij në fuqi.

Me anë të këtij memorandumi mirëkuptimi, palët bien dakord për zbatimin e programit të shkëmbimit akademik Fulbright në arsim, kulturë dhe shkencë, me qëllim realizimin e përfitimeve reciproke në nivel akademik.

Siç thamë edhe më sipër, memorandumi vjen si iniciativë e ambasadës amerikane në Tiranë, iniciativë e cila ka filluar në vitin 2000 dhe është rishikuar në vitin 2016 – 2017.

Ky memorandum është bazuar në modelin e memorandumit të mirëkuptimit, nënshkruar edhe nga disa shtete të tjera.

Programi Fulbright është themeluar në vitin 1945, dhe janë 155 vende që marrin pjesë në të.

Programi ka siguruar 286 mijë pjesëmarrës, të zgjedhur për potencialin e tyre, me mundësinë për të vëzhguar institucionet politike, ekonomike e kulturore të njëri-tjetrit, për të shkëmbyer ide e për të ndërmarrë projekte të përbashkëta, me rëndësi për mirëqenien e përgjithshme.

Nga themelimi i saj, 46 mijë vetë janë shtetas amerikanë, ndërsa 150 mijë janë nga vende të tjera të botës.

Përmbajtja e memorandumit. Me anë të këtij memorandumi mirëkuptimi synohet që çdo vit të përzgjidhen studentë, personel akademik dhe profesionistë nga institucionet e arsimit të lartë dhe institucione të tjera të Republikës së Shqipërisë, për të studiuar në universitetet e Shteteve të Bashkuara, si dhe koordinon dërgimin e studentëve, personelit akademik dhe profesionistëve të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, në institucionet akademike shqiptare, për kërkime apo stazhe akademike.

Në memorandum është përfshirë edhe përfaqësuesi i palës shqiptare në komisionin që ngrihet pranë ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për të përzgjedhur studentët, personelin akademik dhe profesionistët që do të marrin pjesë në këtë program.

Siç thashë edhe më parë, kemi një detyrim financiar, *fee*-ja e të cilit është 150 mijë euro; merret nga fondi i ekselencës, me qëllim krijimin e shumë mundësive për studentët, personelin akademik dhe profesionistët që marrin pjesë në këtë program.

Kontributi do të paguhet duke filluar nga viti akademik 2019 – 2020, deri në vitin akademik 2024 – 2025, ndërsa pranimi do të fillojë nga viti akademik 2020 – 2021.

Arben Ahmetaj – Faleminderit!

Ka ndonjë mendim apo koment?

Atëherë, po them dy fjalë, para se të kalojmë në votim.

Ky është një projekt i rëndësishëm, që ka financuar arsimim për shumë qytetarë shqiptarë. Është në nder të të gjithë atyre që kanë përfituar nga bursat Fulbright apo nga të gjitha bursat. Këtu, në këtë komision, përfshirë edhe mua, ka deputetë që kanë përfituar nga bursat e Kongresit Amerikan apo nga bursat e qeverisë amerikane Fulbright, kështu që një falënderim i veçantë për qeverinë amerikane dhe për Kongresin Amerikan.

Unë mendoj që, meqenëse nuk ka asnjë koment, por vetëm mbështetje, të kalojmë menjëherë në votim. Apo jo, Alma?

Atëherë, votojmë në parim.

Kush është pro?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, se do ta vazhdojmë për procedurë, kemi shumë punë, të lutem, Turi!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Artur Roshi – Më vjen mirë që kryetari i komisionit e di se opozitën e ka proamerikane. Kaq. Mund të vazhdoni.

Arben Ahmetaj – As që e vë në dyshim. Madje ju falënderoj për mbështetjen. Nuk e vë në diskutim që qasjen e kemi të përbashkët.

Votojmë në parim.

Kush është pro? Kundër? Abstenim? Asnjë kundër. Asnjë abstenim.

Miratohet!

Kalojmë në shqyrtim nen për nen.

Neni 1. Kush është pro?

Kundër? Abstenim?

Miratohet!

Neni 2. Kush është pro?

Kundër? Abstenim?

Miratohet!

Në tërësi. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet!

Faleminderit, zoti zëvendësministër!

Kalofshi mirë!

Arben Ahmetaj – Vazhdojmë me “Ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin teknik 2018, për projektin “Menaxhimi i modernizuar i mbetjeve dhe ekonomia ricikluese në respekt të mjedisit”.”

Më sillni edhe marrëveshjen financiare!

Zoti Ministër, faleminderit që erdhët, me gjithë punët e mëdha që keni!

Një falënderim edhe nga komisioni në lidhje me punën e palodhur për strehimin e të gjithë qytetarëve që u dëmtuan nga tërmeti në banesat e tyre, në pasuritë e tyre.

Zoti Ministër, puna juaj në funksion të emergjencës bëri diferencë. Ne e kemi diskutuar edhe në komision. Faleminderit edhe nga ana e opozitës, sepse ma kanë transmetuar. Falënderime edhe nga pozita, patjetër.

Do të doja që ju të mos lexonit relacionin, por të fokusoheni drejtpërsëdrejti tek marrëveshja. Gjithashtu, dua edhe marrëveshjen financiare, që ta kalojmë së bashku. Dakord?

Ju lutem, zoti Ministër, mos e lexoni relacionin, por le të futemi menjëherë në çështje.

Blendi Klosi – Zoti kryetar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Ajo që do të doja të thosha, është që, në kuadër të tërë punës që kemi ndërmarrë, sa i përket stabilizimit të situatës post-tërmet, ka qenë shumë i nevojshëm komunikimi me njerëzit. Prandaj, do të doja të falënderoja të gjithë kolegët deputetë, të të dyja krahëve, të cilët kanë qenë pranë njerëzve, dhe së bashku me shumë e shumë faktorë të tjerë të kësaj shoqërie, ia kemi dalë ta kemi nën kontroll situatën dhe problemin e krizës.

Ajo që kemi zgjidhur javën e parë dhe ditët e para të problematikës, ka qenë jeta e njerëzve dhe sistemimi i tyre. Prandaj, komplimenti që ju më bëni është një kompliment i përbashkët....

Arben Ahmetaj – Ju lutem, mbani qetësi, përfshirë edhe mua, që të mund të dëgjojmë ministrin. Faleminderit, zoti Vullnet, për tërheqjen e vëmendjes që na bëre!

Blendi Klosi – Për sa i përket marrëveshjes që vjen sot, ajo është një marrëveshje tashmë e dakordësuar mes qeverisë e federale të Gjermanisë dhe Këshillit të Ministrave, me titull: “Menaxhimi i modernizuar i mbetjeve dhe ekonomia e ricikluese në respekt të mjedisit”. Është një marrëveshje, e cila ndodhet në fazën e saj të tretë dhe vjen si produkt i përbashkët i dy institucioneve tona, por natyrisht është e implementuar nga menaxhimi 100 % i partnerëve gjermanë nëpërmjet GIZ-it, dhe arrin në vlerën e 4, 5 milionë eurove, me synime të qarta në tre aspekte:

Së pari, këshillon dhe asiston institucionet e mjedisit për të rritur kapacitetet e tyre dhe për të forcuar menaxhimin e këtij sektori.

Së dyti, është një rezultat i pritshëm, që ka të bëjë drejtpërdrejt me investimet që ka ky projekt në rehabilitimin e disa prej pikave ilegale, që ne kemi në kuadër të menaxhimit të mbetjeve urbane.

Po ashtu, ka asistencë të drejtpërdrejtë për gjashtë bashki, të cilat do të duhet të stabilizojnë landfillet e tyre të vegjël, për të shkuar më pas në zgjidhjen e masterplanit masiv, për sa i përket trajtimit të mbetjeve urbane në vendin tonë.

Përmirësimi në marrëveshjen e tretë është: në qoftë se në dy të parat ka qenë asistencë teknike, marrëveshja e tretë, që vjen sot për miratim në komisionin tuaj të nderuar, e pastaj në parlament, është se marrëveshja do të synojë edhe investime konkrete, siç e thashë, në gjashtë bashki, të cilat do të kenë rehabilitim të plotë të sistemit të menaxhimit të mbetjeve urbane në landfillet e tyre. Natyrisht, bashkitë janë të nivelit të dytë.

Ajo që po përpiqemi të bëjmë ne, si Ministri e Mjedisit, së bashku me gjithë pushtetin lokal, është që të kemi për herë të parë në Shqipëri një sistem të plotë të menaxhimit të mbetjeve urbane. Po ashtu, do të kemi certifikimin nëpërmjet lejeve ligjore e mjedisore të sa më shumë sistemeve të trajtimit të mbetjeve urbane në vendin tonë.

Prandaj them se ky projekt, përveç se ka dimensionet që ju përmenda para pak, sa i takon mbështetjes për ngritjen e kapaciteteve dhe përafrimit të legjislacionit, ka edhe dimensionin e saj shumë të rëndësishëm: zgjidhje konkrete për gjashtë bashki të vendit, në kuadër të certifikimit e të trajtimit të mbetjeve urbane.

Kjo është një përpjekje që, siç e thashë, ne e kemi ndërmarrë me të gjithë donatorët e tjerë. Do të përpiqemi që brenda vitit 2020 të stabilizojmë mbi 200 vende depozitimi ilegale, që kemi në territorin e vendit, e po ashtu t’u krijojmë të 61 bashkive të vendit një sistem të licencuar trajtimi të mbetjeve urbane, duke trajtuar qarqet si zona të trajtimit të mbetjeve urbane, duke zgjidhur

nëpërmjet landfilleve, në zonat ku ka landfill, apo landfilleve dhe inceneratorëve në zonat ku po investohet për inceneratorë, si dhe që bashkitë më të vogla të kenë mundësinë që nëpërmjet këtyre investimeve të përbashkëta të qeverisë shqiptare e të donatorëve, ku partnerët gjermanë morën përsipër gjashtë bashki të vendit, të bëhet e mundur që edhe bashkitë e nivelit të dytë të kenë një landfill me karakteristika të licencuara e me kritere të miratuara, në kuadër të lejeve mjedisore.

Arben Ahmetaj – Faleminderit, zoti Ministër!

Opozita, faleminderit që nuk keni komente!

Pozita, faleminderit që nuk keni komente!

Kalojmë në votim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Patjetër! Siç e thatë edhe në momentin e parë, i keni të mbështetura të dyja, edhe marrëveshjen financiare.

Faleminderit, zoti Ministër!

Kalojmë në votimin në parim të projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin teknik 2018, për projektin “Menaxhimi i modernizuar i mbetjeve dhe ekonomia ricikluese në respekt të mjedisit”.”

Faleminderit që do të na ndihmoni edhe bashkitë!

Kush është pro, në parim?

Kundër? Abstenim?

Miratohet!

Kalojmë tek nen për nen.

Neni 1. Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin teknik 2018, për projektin “Menaxhimi i modernizuar i mbetjeve dhe ekonomia ricikluese në respekt të mjedisit.””, sipas tekstit që i bashkëngjitet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet!

Neni 2: “Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare”.

Kush është pro? Kundër?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ajo ka kaluar. Për nenin 2, aty jeni pro për 24 orë.

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet!

Në tërësi. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet!

Kalojmë te marrëveshja financiare “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunim financiar 2018, për projektin e programit “Për infrastrukturën komunale 5”.”

Votojmë në parim. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet!

Kalojmë në nen për nen.

Neni 1. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet!

Neni 2. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet!

Votojmë projektligjin në tërësi.

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet!

Faleminderit, zoti Ministër! Punë të mbarë! Kalofshi mirë!

(Diskutime pa mikrofon)

Më falni, do t’i punojmë së bashku, zonja deputete, e më pas do ta formatojmë në tërësi. Këtu kemi specialistët më të mirë të fiskut, në Republikën e Shqipërisë, të cilët do të na ndihmojnë.

(Diskutime pa mikrofon)

Edhe asistencën e huaj do të na e sjellin këtu, për të na ndihmuar. Do ta mbarojmë, sepse praktikisht e kemi ligjin bazë. Të gjithë ndryshimet ë bëhen në paketë, janë të referuara te ky ligj.

Artur Roshi – Kryetar, ne inxhinierët i themi lodhje e strukturave. Me këtë qëndrimin tuajt paduruar, për të respektuar etikën, nëse kemi apo s’kemi fjalë ne si opozitë, ne mund të themi që s’kemi. Në emër të maxhorancës mund të flasësh. Në emër të opozitës, jo.

Arben Ahmetaj – Dakord, po!

Artur Roshi – Kjo tregon se edhe strukturat e qeverisë janë lodhur, dhe nuk e përballojnë dot tërmetin.

Arben Ahmetaj – Faleminderit! Vërejtja juaj konsiderohet. Që këtej e tutje, megjithëse më thoni që s’keni komente, unë prapë do t’ju pyes dy herë. Ju më thatë se s’keni. Unë ju pyeta. Dakord!

Faleminderit!

Kalojmë te pika 4: Shqyrtimi i projektligjit “Për ndryshim në ligjin 55/2015 “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar”, nismë e deputetit Ilir Beqaj.

Zotin Beqaj nuk e kemi këtu. Unë po ju lexoj relacionin, shumë shpejt.

Pra, baza ligjore kushtetuese. Propozimi është propozim i një deputeti, në mbështetje të nenit 81, pika 1 e Kushtetutës, dhe është hartuar në përputhje me nenin 68 të Rregullores së Kuvendit. Projektligji bazohet në nenet 78, 83, pika 1 të Kushtetutës, dhe miratimi i tij i nënshtrohet rregullit të përgjithshëm, për sa i përket shumicës.

Qëllimi i projektligjit parashikon ndryshimin e nenit 36, duke shtyrë afatin përfundimtar të paraqitjes së kërkesave nga subjektet investuese, të interesuara për përfshirjen në procedurat për përfitimin e statusit investitor strategjik, procedurë e asistuar, procedurë e veçantë, deri më 31 dhjetor 2020. Arsyeja është fare e thjeshtë: qeveria akoma nuk ka mbaruar ligjin organik për investimet e huaja, ose për investimet në tërësi. Kësisoj, i japim mundësi investitorëve, që ta përdorin instrumentin brenda ligjit të investimeve strategjike edhe për vitin 2020, deri kur qeveria të na sjellë ligjin e detajuar.

Faleminderit!

Kush ka pyetje? Po, zonja deputete.

Edlira Hyseni – Unë e kam pyetjen e thjeshtë, sepse ky projektligj kalon me procedurë të përshpejtuar, por është kaq e përshpejtuar sa s’po kuptojmë si po hyn e po del.

Duhet të kemi parasysh ligjin bazë për të kuptuar se çfarë përmban, por gjithsesi konceptet kryesore i kemi parasysh.

Meqenëse ju kërkon shtyrjen e afatit për një vit, a keni një informacion se çfarë ka prodhuar ndërkohë, deri në vitin 2019? Sa investitorëve të huaj u është dhënë ky status? Sa të mira kemi pasur, për të kuptuar pse duhet të shtyhet edhe një vit?

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Urdhëroni, zonja Belinda Ikonimi!

Belinda Ikonimi – Ne jemi duke punuar për ligjin e unifikuar të investimeve, një proces i cili po kryhet edhe me mbështetjen e ekspertizës së Bankës Botërore, të IFC-së, dhe aktualisht prioriteti i qeverisë është që pas një faze të gjerë konsultimi të këtij projektligji ky të miratohej

brenda vitit 2019. Ne e mbështesim propozimin e deputetit, pasi, duke miratuar këtë ndryshim të këtij neni, nuk krijohet një boshllëk ligjor, në mënyrë që investitorët të mos kenë ku të aplikojnë.

Për sa i përket zbatimit të ligjit “Për investimet strategjike” deri tani të gjitha të dhënat janë të publikuara në faqen zyrtare të AID-ës dhe çdo gjë është publike. Kemi rreth 14 investime strategjike të miratuara me vendime të Komitetit të Investimeve Strategjike.

Ndryshimi i këtij neni për ndryshim afati nuk do të thotë detyrimisht se ky ligj do të jetë në fuqi deri në datën 31 dhjetor 2020, pasi në momentin që ligji i ri mund të miratohet brenda muajit janar, në mënyrë automatike ky projektligj përfundon, se kjo është vetëm për të mos krijuar një boshllëk ligjor në mënyrë që investitorët të mos kenë mundësi për të aplikuar.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj - Faleminderit!

A ka pyetje tjetër? Nuk ka.

Hedhim në votim nismën e deputetit Beqaj.

Hapim votimin në parim.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Votojmë nen për nen.

Neni 1.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Hapim votimin në tërësi.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Faleminderit, zonja zëvendësministre!

Arben Ahmetaj - Kemi pikën 5, nisma për propozimin e projektligjit “Për rivlerësimin e pasurive të paluajtshme”. Kjo është nismë e deputeti Arben Ahmetaj. Qëllimi i projektaktit propozohet në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe nenit 155 të Kushtetutës.

Ky projektligj ka për qëllim realizimin brenda një kohe të shkurtës dhe me kosto mjaft të ulët për individët të rivlerësimit të pasurive të paluajtshme dhe nxitjen e tregut të pasurive të paluajtshme.

Ky projektligj nuk është parashikuar në programin analitik. Miratimi i këtij projektligji do të ketë efekte të drejtpërdrejta në nxitjen dhe formalizimin me vlerën e tregut të pasurive të paluajtshme, nisur edhe nga përvoja ndër vite. Rivlerësimi i pasurisë së paluajtshme ka përbërë një ndër aktet ligjore me interes për qytetarët, duke sjellë një risi të konsiderueshme të këtyre rivlerësimeve të shoqëruara edhe me regjistrime të shumta pranë agjencive shtetërore të Kadastrës. Propozimi im ka për qëllim t’u ofrojë edhe një herë qytetarëve mundësinë e rivlerësimit të pasurive të paluajtshme deri në 30 gusht 2020.

Ky afat i propozuar vlerësoj se është një afat optimal për përmbushjen e dispozitave të këtij projektligji. Pjesa e rëndësishme është 3%-shi i vlerës, por këtë do të diskutojmë te neni specifik.

Unë mendoj se për shkak të rivlerësimit do të ketë një të ardhur në buxhetin e shteti, rreth 4 miliardë. Nëse ju kujtohet, Ministria e Financave e prezantoi si pjesë të paketës së vet, por nuk e kishte sjellë si draftligj.

Niko Lera – Ne jemi dakord me propozimin tuaj, sepse ne e kishim parashikuar edhe në projeksionin e buxhetit të vitit 2020. Ne bëmë vetëm një axhustim të datës, sepse e kishim parashikuar implementimin e ligjit nga 1 janar – 30 qershor 2020, por gjykojmë që për dy shkaqe, për situatën post-tërmet, i cili mund të heqë vëmendjen e publikut për 2-3 muajt në vijim dhe, e dyta, t’u japim mundësi emigrantëve të cilët kryesisht vijnë në periudhën korrik-gusht, për të bërë rivlerësimin propozojmë që afati të shtyhet deri më 31 gusht 2020.

Arben Ahmetaj – Me 30 gusht e kam unë këtu. Ju thoni ta shtoj edhe një ditë? Dakord. Faleminderit, për mbështetjen!

Kush ka ndonjë koment?

Urdhëroni, zoti Angjeli!

Anastas Angjeli – Të nderuar kolegë,

Unë i vlerësoj të dy nismat e të dy kolegëve. Në fakt, atë të parën nuk e kuptoj pse ministria nuk e kishte në vëmendje që afati mbaronte dhe nuk e solli.

Detyra e ministrisë kjo është, që nëse një ligji i mbaron afati, duhet ta kishte sjellë, por shumë mirë që e solli një deputet se puna u krye.

Komenti i dytë është për nismën e dytë për rivlerësimin e banesave. Kjo nismë është sa e nevojshme, aq e domosdoshme, aq edhe aktuale.

Ne kemi bërë rivlerësim të banesave dhe qytetarët nuk kanë arritur në kohë ta realizojnë të gjithë këtë mundësi që u dha ligji dhe qeveria dhe atëherë nuk bëjmë një shtytje afati. Po të bënim një shtyrje afati, do të përsërisnim të njëjtën gjë në të njëjtat kushte. Në këtë rast kemi një ndryshim, kemi përsëritjen e procesit, por jo në të njëjtat kushte, por në kushte më lehtësuese për qytetarët.

Këtu u fol për përfitimet që ka buxheti, por ne nuk e bëjmë vetëm për përfitimet që ka buxheti, por e bëjmë se duam t'u japim mundësi qytetarëve, të cilët nuk arritën ta realizonin këtë gjë me ligjin e mëparshëm. Pra, kemi një përfitim të dyfishtë, edhe për buxhetin, edhe për qytetarët.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Urdhëroni, zoti Roshi!

Artur Roshi – Përderisa ligji nuk vlen nga qeveria, por vjen nga një deputet, që konkretisht është kryetar i Komisionit të Ekonomisë dhe ish- ministër i Ekonomisë, do të thotë që zoti Ahmetaj monitoron në një farë mënyre Ministrinë e Ekonomisë dhe nuk ka hequr ende dorë nga posti i mëparshëm i tij.

Kjo nuk është se na shqetëson, por thelbi i këtij propozimi, në qoftë se ne do të mendonim realisht për qytetarët, do të ishte ai tatimi 15% që paguhet për transkriptimin e pronës nga shitësi te blerësi.

Ju thonë se ne këtë e rivlerësojmë deri në fund të gushtit dhe kemi 3% të diferencave, sa ka qenë e vlerësuar dhe sa është, që e keni caktuar ju për tregun. Pra, vlerën e tregut e keni përcaktuar përsëri ju sipas zonave.

Vlera historike, që do të thotë se në momentin që është hipotekuar ka një diferencë nga vlera aktuale, e cila është përcaktuar në mënyrë nominale nga qeveria, për mua është një vlerë e lartë ajo që është përcaktuar, sepse ka zona ku tregu është më poshtë, edhe në qira, edhe në shtije, dhe qeveria ka vendosur vlera më të larta. Në qoftë se vlerësimi bëhet nga një eksperti del, po themi me 800 euro metri katror, ndërsa qeveria ka vendosur tavanin në 1000 euro metri katror (po marrim pjesën poshtë Zogut të Zi), këtu ka një mospërputhje midis asaj që ka vendosur qeveria. Me idenë për të mbledhur taksa, ajo ka vendosur referenca të larta, dhe këtë pikë unë e quaj ngërç logjik.

Si do të zgjidhet ky 3%-ësh? Pra, kam rezerva për shkak të 3%-shit, edhe po të shohim historikun në vitin 2013, e kemi 1% (vetëm qeveritë tuaja e kanë bërë 2%, kurse tani po e bëjnë 3%), pra jemi në një situatë krize, se u kërkojmë më shumë para qytetarëve.

Logjika duhet të jetë mbi transkriptimin, në qoftë se duam të ndihmojmë qytetarët, pra 15%-shi duhet të ulet. Në qoftë se do të vinte amendamenti nga 15% të bëhej 7%, ta bëjmë 5%, kjo duhet të jetë një gjë e përhershme për qytetarët.

Nuk duhet të punojmë me aksione, me demagogji, që të marrim një dorë lekësh tani, se jemi keq, se kemi buxhetin, se herën tjetër mbledhëm 4 miliardë, kurse tani duam të mbledhim 6 miliardë, këto janë përralla që nuk vlejnë për qytetarët.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj - Faleminderit!

Së pari të sqarojmë metodologjinë. Jemi duke folur për rivlerësim të pasurive të paluajtshme, pavarësisht i shet apo nuk i shet, nga vlera historike te vlera e tregut.

Vlera e tregut ka konceptin e vlerës reale të tregut dhe të vlerës fiskale. Në rastin konkret, nuk jemi duke iu referuar taksës së pasurisë, por jemi duke folur për vlerën që do të bëjnë vlerësuesit e licencuar dhe mbi atë vlerë do të paguhet 3%-shi.

A përfitojnë qytetarët? Ata përfitojnë drejtpërdrejt. Nuk ka rëndësi nëse e shet sot apo e shet mot. Ti rivlerëson pasurinë tënde, të cilën mund ta përdorësh nesër me vlerën e rivlerësuar si kolateral në bankë, nëse do të të duhet. Banka bën vlerësim tregu, por ky është vlerësim zyrtar, ku ti ke paguar taksën. Pjesa tjetër e buxhetit është konsekuencë pozitive.

E bëjmë tani se ka pasur shumë kërkesa në Ministrinë e Financave dhe ne menduam që pas gjithë këtyre dëmeve që kanë ndodhur nga tërmeti t'u japim mundësi qytetarëve për një rivlerësim.

Kjo është një politikë afatgjatë dhe të jeni të bindur se 3%-shi është normal, është në nivelet minimale të asaj që ne mendojmë se duhet të jetë dhe unë jam i bindur se do të përfitojnë gati 40 mijë familje. Kaq janë, zoti Niko?

Niko Lera – Ne kemi llogaritur që, bazuar edhe në përvojat e viteve të kaluara, rreth 50 mijë pronarë të rivlerësojnë shtëpitë e tyre.

(Diskutime pa mikrofon)

Kryetari i komisionit na ka ngarkuar me mbledhjen e të dhënave dhe evidencave dhe ne këtë kemi bërë. Unë po shpjegoj ato të dhëna që kemi sjellë sipas kërkesës së kryetarit të Komisionit të Ekonomisë.

Janë rivlerësuar 93 mijë pasuri...

(Diskutime pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Ky është autoriteti fiskal dhe do të mbajë qëndrim...

(Diskutime pa mikrofon)

Urdhëroni, zoti Niko!

Niko Lera - Bazuar në detyrën që ju na ngarkuat nxorëm të dhënat sa pasuri janë rivlerësuar në vite, kështu në vitet 2011-2013 janë rivlerësuar 93 mijë pasuri, në vitet 2016-2017, 62 mijë pasuri dhe mendojmë që për këtë periudhë 8-mujore të rivlerësohen 50 mijë pasuri, të cilat me tarifën 3 % që ju propozuat do të gjenerojnë 6 miliardë lekë në buxhetin e shtetit, nga të cilat do të reduktohen në 2 miliardë lekë që do të humbasin nga tatimi mbi kalimin e së drejtës së pronësisë. Pra, efekti neto do të jetë 4 miliardë lekë që ju e përmendët pak më parë.

Arben Ahmetaj- Po, zonja Blerina.

Blerina Gjylameti- Faleminderit!

Faleminderit për përgjigjen ndaj shqetësimit të qytetarëve në lidhje me afatet që skadonin për rivlerësimin e banesave. Kjo është një zgjidhje për të gjithë ata që kanë kërkuar të vazhdojnë me atë nismë që patëm para disa kohësh, që banesat e tyre të kenë një vlerë reale tregu dhe që i ndihmon për një sërë ndryshimesh që mund të kenë në pronësi e të tjera. Duke parë efektshmërinë e kësaj nisme më parë, unë mendoj se është momenti i duhur për të vazhduar si një përgjigje edhe ndaj një situatë emergjente, por mbi të gjitha për diçka që është në normalitetin e gjithkujt. Si deputete e Tiranës, ku kërkesat kanë qenë edhe më të shumta, unë jam shumë e kënaqur për këtë gjë.

Ndërkohë, kam një kërkesë që të mos vazhdojmë me nivelin 3%, por ashtu siç e kemi pasur, 2%. Mendoj se në këto momente kjo duhet të ishte zgjidhje e duhur dhe racionale. Kemi pasur debate së bashku edhe kur ju keni qenë ministër për këtë, që të vazhdonte procedura në një afat më të gjatë, kështu që sot e vlerësoj shumë.

Arben Ahmetaj - Po, zonjë.

Edlira Hyseni - Unë personalisht kam qenë pro ndaj një nisme të tillë, që është marrë edhe herët e kaluara për rivlerësimin e pasurive të paluajtshme të individëve dhe bizneseve dhe është e vlefshme. Nga eksperiencia e kaluar, flas për Durrësin ku kam asistuar, familjarët janë skeptikë, brezi i vjetër mezi bindet të bëjë këtë rivlerësim, qoftë për shkak të procedurave, qoftë për një farë paqartësie për aplikimin.

Kjo është një nismë që besoj se ka kohë që është menduar, por në kushtet aktuale të pastërmetit jemi në kushtet kur banesat jo që nuk janë rivlerësuar, por kemi banesa që janë zhvlerësuar.

Pra, që qytetarët ta kenë të thjeshtë duhet të kuptojnë që pasuritë e tyre do të rivlerësohen në dy mënyra, ose nëpërmjet çmimeve minimale fiskale, që i kanë vetë agjencitë shtetërore, ose

me një ekspert të licencuar privat, që mund t'i japë vlerën e tregut, por në asnjë rast, siç thuhet edhe në projektligj, vlera e re që do të japi edhe vlerësuesi për efekt të tatimit nuk do të jetë më e vogël se çmimi minimal fiskal që ju keni përcaktuar. Pra, nuk është kaq e thjeshtë se çmimet minimale fiskale deri tani janë të përcaktuara. Durrësi ka pasur, në dijeninë time, njëtrajtshmëri, pavarësisht zonave, dhe me sa di unë edhe plazhi konsiderohet si qendra e qytetit, por edhe zona të tjera periferike. Në kushtet aktuale në Durrës të gjithë janë duke menduar për të shitur shtëpitë dhe pallatet që janë në mes të Durrësit nuk kanë më vlerë, i kanë blerë me 600-800 euro, por sot nuk vlejnë as 100 euro.

Pra, efektet financiare të pritshme ju mbase i keni parashikuar përpara, por sot unë mendoj se situata është e ndryshme dhe nuk e di nëse është momenti i duhur për të bërë këtë për Durrësin, i cili nuk ka sot emergjencën e rivlerësimit të pasurive.

Që të mos bëjmë panik, ia vlen të jetohej në Durrës, por unë them se është një nismë shumë e mirë, por nuk është momenti i duhur për ta bërë. Edhe rritja e masës nga 2% në 3% është momenti më i papërshtatshëm për të bindur njerëzit që të paguajnë diçka. Po kështu edhe afati 6- muajor më duket i shpejtë, mund të shtrihet deri në fund të vitit.

Është një projektligj i mirë, unë jam pro për t'u dhënë vlerë aseteve. Bizneset dhe familjarët duhet të ndërgjegjësohen që është një e mirë për ta, por nuk mendoj se është momenti dhe nuk mendoj se do të realizoni të ardhurat e pritshme, të paktën durrsakët nuk e kanë mendjen të rivlerësojnë banesat, shumë shumë ata do të shohin se sa janë zhvlerësuar, madje po flasim për pallate që janë në mes të Durrësit. Ju i keni dhënë një çmim fiskal dhe besoj se nuk do ta ndryshoni, do të lini atë që keni, por sot një pallat në mes të Durrësit nuk vlen sa ç'ka vlejtur para dy muajve. Pra, nuk mund të përdorini të njëjtët parametra, e kritere dhe t'u kërkonin njerëzve të paguajnë për banesa që sot nuk kanë të njëjtën vlerë që kishin dhe përpara. Kjo vlen edhe për Tiranën, por sidomos në Durrës sot kushtet janë ndryshe dhe ju nuk mund të propozoni të njëjtin projektligj ashtu siç e kishit menduar para një muaji dhe ta sillni dhe sot pas një muaji.

Gjithashtu, unë mendoj se duhet ta bëni 1%, se mbase i motivoni me të.

Arben Ahmetaj- Për sqarim, çmimet minimale fiskale janë referencë e vlerës së tregut dhe vendosen me vendim të Këshillit të Ministrave, me një metodologji racionale dhe shkencore. Iniciativa nuk është detyruese.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, unë nuk ju ndërhyra!

Pra, nuk është detyruese. Çdo qytetar ka të drejtën e vet ta rivlerësojë ose ta mbajë në atë vlerë që ka, varet se çfarë planesh ka për pronën e vet, për të marrë kredi ose shitur, por ne i japim një mundësi që ai të vijë në vlerat e tregut. Vlerat e tregut kanë metodologji, e cila është e bazuar në një akt ligjor dhe nënligjor.

Së dyti, unë jam i bindur që Durrësi po ringrihet, edhe nga ana shpirtërore dhe çdo moment për të dhënë një mundësi pozitive për qytetarët është momenti i duhur. Unë besoj se me këtë iniciativë i lehtësojmë. Jam i bindur që është momenti i duhur.

Besoj, gjithashtu, se 3% është niveli minimal për të promovuar rivlerësimin. Jam i bindur që do të ketë të ardhura në buxhet, sipas mendimit tim rreth 4 miliardë, por gjithsesi këto janë planifikime dhe në referencë dhe diskutim me Ministrinë e Financave janë gati 60 mijë qytetarë që do ta rivlerësojnë. Ta dini që ka ardhur edhe si rezultat i një kërkesë të vazhdueshme dhe nga disa burime, qytetarë dhe grupe interesi.

Faleminderit, ndonjë koment tjetër?

Po, z. Angjeli.

Anastas Angjeli – Çështja shtrohet nëse duhet një veprim i tillë apo nuk duhet. Po të matësh anët pozitive dhe ndonjë sugjerim që bëhet, ligji duhet. A është në kohë? Është në kohë, sepse kemi një deficit të plotësimit të numrit të qytetarëve në krahasim me ligjin e mëparshëm. Ishte ligji në fuqi, i mbaroi afati dhe nuk arritën njerëzit qytetarët që të plotësonin kërkesën e tyre aq sa ishin, pa detyrim, me dëshirën e dhe vullnetin e tyre, për të realizuar një qëllim të tyre jo të buxhetit. Pra, po ta shikosh nga ky këndvështrim, nuk ke se çfarë të thuash.

Tani ju ngrini një shqetësim që ka të bëjë me çmimet e referencës, me një vendim të Këshillit të Ministrave.

Ju lutem, më lini të flas!

Pra, kemi këtu vlerën dhe çmimin e referencës. Pa dyshim ky ligj do ta konsiderojë atë, por nuk është ky ligj objekt i ndryshimit të tij. Pse kur e bëmë ligjin e rivlerësimit nuk u mor kush me çmimin e referencës. Pse? Sepse atij do t'i referohesh, sepse ajo është një metodologji e caktuar bashkëkohore. Kështu që nuk ke se çfarë të bësh. Nuk mund të ndryshosh vendimin e qeverisë, as metodologjinë dhe ta lësh të lirë këtë gjë. Prandaj, të mos bëjmë lojëra fjalësh. E tha zoti Ahmetaj pse e ka marrë nismën, edhe Ministria e Financave e tha që e ka pasur në plan për të bërë diçka të tillë. Kjo u bë për disa arsye. Arsyeja numër një është se kjo nuk është një eksperiencë që nuk është zbatuar në vendin tonë dhe gjatë zbatimit të saj ka pasur efekte pozitive për qytetarin, së pari, për buxhetin e shtetit, së dyti. Numri i njerëzve, i qytetarëve dhe pronarëve është aq i madh

sa kërkesat e tyre duhen konsideruar, prandaj ka shtet dhe qeveri. Nëse njerëzit adresohen për një shqetësim të tyre, pavarësisht se prindërit kanë një mentalitet që nuk e kuptojnë, na vjen keq, por fëmijët tyre e kuptojnë shumë mirë dhe i kanë marrë për dore dhe i kanë çuar prindërit atje që të hedhin firmën. A është kështu?

Atëherë, duhet të jemi më realistë që sugjerimet që ju keni mund të konsiderohen aq sa mund të konsiderohen. Ju keni propozimin tuaj, ne kemi tonin. E vendosim me votë këtu. Është i domosdoshëm, koha tani e solli, sepse kërkesat janë 60 mijë dhe ato janë të vazhdueshme për qeverinë. Ne mund të diskutojmë a të vendoset 2% ose 3%, këtë mund ta diskutojmë, po ashtu edhe afatin. Kush na pengon ne që më 31 gusht nga 60 mijë kanë vajtur në 25 mijë dhe afati të bëhet deri më 31 dhjetor? Po të paktën të kemi një afat që njerëzit të motivohen. Pastaj ja ku është ministria, mund t'i themi nëse kanë shkuar 30 mijë, atëherë e shtyjme afatin. Unë nuk besoj se është kaq alarmante sa e shprehni.

Arben Ahmetaj- Faleminderit!

Do t'ju lutesha që të jeni racionalë në fjalën tuaj!

Zoti Roshi .

Artur Roshi –Thelbi këtu nuk është ai. Pse janë këto kërkesa? Duhet të gjejmë shkakun. Sipas meje këto kërkesa janë për shkak të atij 15%-shit që tatojmë pronën, kur bëjmë transkriptimin e saj. Janë bllokuar kolateralet e tyre, prandaj, kanë lindur ato kërkesa. Çfarë bëni ju tani? Nuk doni ta ndryshoni 15%-shin, dhe thoni që të bëjmë një rivlerësim që kaq sa kërkesa kemi, t'i bëjnë këto transkriptime nga filani te fisteku. Po pse të mos ulim 15%-shin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju edhe fitimin që mendoni që e jep qytetari e jep brenda për një kohë të caktuar me aksion. Pra, qytetari edhe përfitimet t'i ketë vetëm me aksion. Jo, qytetari duhet të jetë i sigurt për jetën, duhet që edhe marrëdhëniet me pronën t'i ketë stabil. Stabiliteti është kur ne nuk i ndryshojmë taksat përditë.

Pra, ka qenë 5%, e bëtë 15%, qeveria juaj, pse? Tani po e shikoni se po bllokohet. E zhbllokoni për 6 muaj, thoni ta shohim se mbase nuk bllokohet tërësisht. Pas 6 muajsh po që prapë një situatë e tillë, thoni ta shtyjme. Pra, nuk funksionon. Përderisa nuk funksionon të futemi te thelbi i çështjes, dhe thelbi është që nga 15% ta çojmë 7%, 5%. Kjo është për t'u diskutuar. Kjo është logjika. Pastaj se vijmë këtu ne për të mirë të qytetarëve e kështu me radhë, çdo kush vjen për të mirë të qytetarëve, sipas mendimit të vet. Mënyra e mendimit tim është tjetër, mënyra e mendimit tuaj tjetër por çdo kush mendon se ne jemi për të mirën e qytetarëve. Këtë e dimë.

Arben Ahmetaj - Shumë të drejtë keni, secili ka mendimin e vet, prandaj ju kërkoj që të mos i ndërhyjni njëri-tjetrit kur shpreheni. Secili pastaj në finale e mbron mendimin me votë. Kush është kundër përfitimit të qytetarëve, në këndvështrimin tim, voton kundër, kush është pro, voton pro. Kjo është e qartë.

Do t'ju lutesha që të keni kujdes etikën dhe të mos i ndërhyjni njëri-tjetrit.

Po, zonja Senida.

Senida Mesi – Kisha një koment në lidhje me atë që tha zoti Roshi, në fakt, ndaj një elementi të diskutimit të tij. Kur të përfundojë procesi, jo tani, Ministria e Financës dhe Ekonomisë të na sjellë një rezumë të përgjithshme për dy amendamentet që ne kemi bërë, edhe të qeverisjes së mëparshme, por edhe të kësaj qeverie, si ka qenë trendi i regjistrimit.

Ndoshta është e udhës që pas kësaj analize ne të rishikojmë në një moment të dytë edhe tatim – fitimin mbi individin.

Arben Ahmetaj – A keni ndonjë koment për iniciativën?

Senida Mesi – Iniciativa është shumë e mirë. Ajo gjen përgjigje për shumë qytetarë, të cilët kanë kohë që e kanë kërkuar një gjë të tillë. Vjen në momentin e duhur. Jam dakord me çfarë tha zoti Angjeli, kështu që e mbështes totalisht. Kam një koment të vogël kur të kalojmë në shqyrtimin nën për nën.

Korab Lita - Unë nuk do të zgjatem, pasi parafolësit i thanë pretendimet dhe të mirat. Normalisht, në një farë mënyre kjo është amnisti në funksion të ligjit ekzistues prej 15% dhe këto gjithmonë janë të mira. Pavarësisht se gjithmonë ka detaje që mund të bëhen më mirë.

Unë nuk do të hyj në hollësi të përfitimeve që sjell për qytetarët, por do të doja të bëja një marrëveshje me ju si propozues, me qëllim që ta bëjmë 2%.

Arben Ahmetaj – Do ta propozoni te neni.

Atëherë votojmë iniciativën në parim. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenime? Nuk ka.

Miratohet.

Atëherë kalojmë te neni 1 “Rivlerësimi i pasurisë së paluajtshme për individët”, “Të gjithë individët të cilët kanë në pronësi pasuri të paluajtshme kanë të drejtë që nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji deri në datën 30 gusht, 2020 të bëjnë vlerësimin e kësaj pasurie me vlerën e tregut. Ky rivlerësim mund të bëhet nga një ekspert i licencuar për vlerësimin e pasurisë së paluajtshme nga institucionet përkatëse ose nga zyrat vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës. Në rast se individ i zgjedh që të bëjë vlerësimin me një ekspert të licencuar atëherë aplikimi i tij për rivlerësim

të pasurisë së paluajtshme i bashkëlidh edhe aktine vlerësimit të ekspertit. Zyra vendore të Agjencisë Shtetërore të kadastrës përllëgarisin: a) bazën e tatueshme e cila llogaritet si diferencë ndërmjet vlerës së pasqyruar në aktekspertimi, e cila nuk mund të jetë më e vogël se çmimet minimale fiskale dhe vlerës së pasurisë të aktit të regjistruar, ose vlerës së rivlerësuar për të cilën është paguar tatimi; b) tatimin që duhet të paguajë individit për ta regjistruar këtë rivlerësim. Në rast se individit zgjedh që rivlerësimi të kryhet nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës me çmimet minimale fiskale në fuqi atëherë ky fakt shprehet në formularin që i bashkëlidhet aplikimit të tij për rivlerësim. Në rastin e parashikuar në pikën 5 të këtij neni zyrtat vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës përllëgarisin bazën e tatueshme e cila llogaritet si diferencë ndërmjet vlerës së dalë nga rivlerësimi me çmimet minimale fiskale në fuqi dhe vlerës së pasurisë të aktit të regjistruar ose vlerës së rivlerësuar për të cilën është paguar tatimi.” b) tatimi që duhet të paguajë individit për të regjistruar këtë rivlerësim.

Në rastet kur pasuria e paluajtshme rezulton e regjistruar pa një kontratë shitjeje, atëherë si vlerë regjistrimi në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, konsiderohet vlera e çmimeve minimale fiskale në çastin e regjistrimit të aktit të fitimit të pronësisë.

8. Tatimi që paguhet për regjistrimin e këtij rivlerësimi është 3 % e bazës së tatueshme, që përcaktohet sipas pikave 4 dhe 6 të këtij neni.

9. Për rastet e kalimit të së drejtës së pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme në zbatim të ligjit “Për tatimin mbi të ardhurat”, të bëra pas rivlerësimit, tatimi llogaritet sipas normave në fuqi mbi fitimin e realizuar si diferencë e vlerës në momentin e kalimit të së drejtës së pronësisë me vlerën e rivlerësuar për të cilën është paguar tatimi.

Ky është neni 1. Ka ndonjë pyetje apo koment?

Zoti Lita, çfarë propozimi keni?

Korab Lita – Propozimi është që në nenin 1, në pikën 8, vlera e tatimit të bëhet 2 % .

Arben Ahmetaj – Kalojmë në votimin e nenit 1, pika 8, për ta bërë 2%. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

8 vota pro dhe 6 vota kundër.

Në bazë të procedurës, miratohet. Pra, pika 8 ndryshon nga 3%, bëhet 2 %.

Faleminderit për propozimin!

Nuk dua t’jua them problemin e shpenzimeve dhe të ardhurave, sepse do të vijmë sërish këtu në prill.

Hedhim në votim nenin 1 me ndryshimin e propozuar. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë te neni 2: “Rivlerësimi i pasurive të paluajtshme në proces legalizimi dhe regjistrimi”. Doni ta lexoj?

“Subjekt i këtij ligji është edhe rivlerësimi i pasurive të paluajtshme të individëve, të cilët janë në proces legalizimi dhe regjistrimi të pasurisë, sipas legjislacionit në fuqi”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, do t’i përcaktojë Këshilli i Ministrave, sepse ata po i detajojnë procedurat e legalizimit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është me vendim të Këshillit të Ministrave dhe ata mund të aprovojnë procedura më të shpejta, më të lehta, kështu që ua lëmë atyre përgjegjësinë.

Kush është pro nenit 2? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Ky duhet të jetë ligji i vetëm përveç ligjeve ratifikuese, që 100% e komisionit është pro.

Faleminderit që e vlerësoni iniciativën!

Kalojmë te neni 3, “Aktet nënligjore”: “Ngarkohet Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për nxjerrjen e udhëzimit të përbashkët për përcaktimin e procedurave për qëllimet e zbatimit të këtij ligji, si dhe përcaktimin e tarifës së kryerjes së këtij shërbimi nga ASHK-ja brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji”.

Kush është pro nenit 3? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Senida Mesi - ASHK-ja me ligjin e ri është direkt nën varësinë e Kryeministrit dhe është e shkëputur nga Ministria e Drejtësisë. Si rezultat do të doja t’u propozoja anëtarëve të komisionit që të ngarkohen direkt Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe ASHK-ja në lidhje me përcaktimet e mëposhtme dhe të hiqet Ministria e Drejtësisë, për sa kohë që ASHK-ja është nën varësinë e Kryeministrit.

Arben Ahmetaj – Ndjesë, zonjë, por ASHK-ja është agjenci zbatuese, jo agjenci propozuese aktesh.

Faleminderit!

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Senida Mesi – Të jetë vetëm Ministria e Financave.

Arben Ahmetaj – Jo, edhe Ministria e Drejtësisë, patjetër, sepse...

Faleminderit!

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë te neni 4: “Hyrja në fuqi”. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet iniciativa e deputetit.

Kalojmë në votimin në tërësi. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Faleminderit!

Komisioni mbyllet për t’u mbledhur për fiskalizimin.

Deri atëherë, Ministria e Financave duhet të jetë ulur me komisionin, me sekretarinë dhe me shërbimet për të riparë formulimet që kemi diskutuar dhe kemi rënë në parim dakord me ministren e Financave, që kanë të bëjnë me disa elemente që ne i pasqyruam gjatë diskutimit në parim. E para.

E dyta, dua të vendosni që bashku me ministren, nëse propozimet që bërë për TVSH-në e importimit të shtëpive të gatshme, të lëndës së parë për ndërtimin brenda programit të rindërtimit, taksën e infrastrukturës apo edhe taksën doganore apo ndonjë element tjetër, do ta bëni me akt normativ apo do të vini të na ndihmoni ta bëjmë ne si deputetë. Kryeministri ka kërkuar që këto tri elemente të jenë pjesë e paketës. Në qoftë se ju nuk do të na i sillni me akt normativ, atëherë unë marr përsipër t’i bëj si propozime.

Dua që median ta lë të lirë të shkojë në punët e veta më të rëndësishme, se ne kemi një konsultë me Ministrinë e Financave.

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA

Sekretar
Anastas Angjeli

Përgjegjësja e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Sekretar i komisionit
Elvi Prifti